



Pranimi / Dorezuar Punime / Protokole Received / Delivery	15.04	2022	2	vite god year
Udhëzimi / Udhëzime Dir. / Udhëzime Dir. / Udhëzime	2186/2022			
Shtesa / Prilog Appendix				
Sasia / Kolicina Quantity				1/3



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr. 207/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri- Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr. 207/2022 të datës 04.03.2022 të parashtruar nga ankuesja

të cilën me autorizim e përfaqëson avokat kundër organit të punësimit/Shërbimit Korrektues të Kosovës, në çështjen juridike “kërkese nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 15.04.2022, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejueshme ankesa A.nr.207/2022 e datës 04.03.2022 e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës, përmes përfaqësuesit me autorizim, më datë 04.03.2022 ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 1171/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokollit 0103 të datës 03.02.2022 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës për shkak të shkeljeve të dispozitave ligjore dhe vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje referuar Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, më datë 11.03.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankueses në Shërbimin Korrektues të Kosovës, ndërsa ky i fundit nuk ka përcjell përgjigje në pretendimet ankimore, por më datë 21.03.2022 ka dorëzuar shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosje meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 1171/2022 të datës, 04.03.2022 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për

Shërbim Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 03.03.2022; Raportin nga konsulta mjekësore të datës 14.02.2022; Raportin nga konsulta mjekësore të datës 08.02.2022; Udhëzimin për konsulta të datës 23.06.2020; Raportin nga konsulta e datës 25.06.2020; Udhëzimin për konsultim mjekësor të datës 08.07.2020; Raportin nga konsultat mjekësore të datës 09.07.2020; Udhëzimin për konsultat mjekësore të datës 03.03.2021; Raportin nga konsultat mjekësore të datës 04.03.2021; Raportin nga konsultat mjekësore të datës 14.08.2020; Udhëzimin për konsultim mjekësore të datës 13.08.2020; Vendimin me numër të protokollit 0103 të datës 03.02.2022; Vendimin me numër të protokollit 0492 të datës 11.03.2021; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 1308/2022 të datës 11.03.2022; Përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 1452/2022 të datës 21.03.2022; Ndryshimin dhe Plotësimin e Kontratës të datës 13.02.2020; Kontratën e punës së datës 30.06.2018; Përgjigjen në kërkesë me numër të protokollit 0174 të datës 16.02.2022; Kërkesën me numër të protokollit 0128 të datës 09.02.2022; Raportin nga Konsultat mjekësore të datës 08.02.2022; Vendimin me numër të protokollit 0492 të datës 11.03.2021; Udhëzimin nga konsultat mjekësore të datës 03.03.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar provat materiale të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se është e palejueshme ankesa e ankueses

SEPSE:

Nga shkresat e lëndës rezulton se ankuesja në bazë të Ndryshim dhe plotësim të kontratës të datës 13.02.2020 ka qenë e emëruar në pozitën *Zyrtare Korrektuese* në Qendrën Paraburgimit në Lipjan (Qendra Korrektuese për Femra). Më kërkesë të ankueses, Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës me Vendimin me numër protokollit 0492 të datës 11.03.2021, ka transferuar ankuesen në pozitë të njëjtë nga Qendra e Paraburgimit në Lipjan /Qendra Korrektuese për Femra në Qendrën Korrektuese në Lipjan. Ndërsa me datë 03.02.2022 Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës me Vendimin me numër protokollit 0103 ka transferuar përkohësisht ankuesen përkatësisht për periudhën nga data 07.02.2022 deri me 07.07.2022 në Qendrën e Paraburgimit në Lipjan.

Ankuesja e pakënaqur me këtë vendim parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të shkeljeve të dispozitave ligjore dhe vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike. Me tej shton se ankuesja ka punuar për disa vite në Qendrën e Paraburgimit në Lipjan, mirëpo për shkak të një rasti të vetëvrasjes në këtë qendër e njëjta ka pësuar probleme shëndetësore dhe vazhdimisht është trajtuar të mjeku, ku për shkak të këtyre shqetësimeve ankuesja ka bërë kërkesë për transferim nga kjo pozitë e punës dhe me vendimin e Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm ishte transferuar në Qendrën Korrektuese në Lipjan, ku dhe gjendja e saj shëndetësore kishte filluar që të përmirësohej. Kërkon që Këshilli ta aprovoj ankesën e saj si të bazuar dhe të anuloj Vendimin me numër protokollit 0103 të datës 03.02.2022 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publikë i zbatueshëm nga data 09.07.2020 sipas Aktgjykimit me numër reference AGJ 1583/20 të datës 09.07.2020 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, përkatësisht sipas nenit 4 të këtij Ligji me të cilin është përcaktuar se: *1.Nëpunësit profesional të shërbimit diplomatik dhe shërbimi korrektues janë nëpunës civilë me status të veçantë, të cilët rregullohen me këtë ligj dhe me ligj të veçantë, 2.Rregullimi me ligj të veçantë, sipas paragrafit 1 të këtij neni, duhet të jetë në pajtim parimet e përcaktuara me këtë ligj dhe mund t'i rregullojë ndryshe vetëm këto elemente të marrëdhënies së punës: 2.1. kushte të veçanta apo shtesë për rekrutim; 2.2. të drejtat ose detyrimet specifike të tjera nga ato të parashikuara me këtë ligj; 2.3. rregullat e veçanta për zhvillimin e karrierës sipas sistemit të gradave; 2.4. zhvillimin profesional dhe nevojat për trajnime; 2.5. transferimin*

dhe sistematizimin e nëpunësve, rrjedhimisht me hyrjen në fuqi të këtij ligji, nëpunësit e shërbimit korrektues kanë statusin e nëpunësve civilë me status të veçantë, respektivisht së të njëjtit i nënshtrohen legjislacionit në fuqi për nëpunësit civil si dhe ligjeve të veçanta lidhur me fushat e specifikuara sipas paragrafit 2 të nenit 4 të këtij ligji.

Përkitazi me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ngritura në ankesë, Kolegji i Këshillit ka analizuar nenin 225 të Ligjit Nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, me të cilin është përcaktuar se: 1. *Personi i punësuar në Institucionin korrektues nga neni 221 paragrafi 1. i këtij ligji, për shkak të nevojave të punës, apo për shkak të rritjes së vëllimit të punëve, mundet të transferohet përkohësisht pa pëlqimin e tij në Institucionin tjetër korrektues më së gjati gjashtë (6) muaj gjatë dy (2) viteve, ndërsa me pajtimin e tij më së gjati dymbëdhjetë (12) muaj.* 2. **Vendimin për dërgimin e nxjerrë Drejtori i Përgjithshëm, kundër të cilit nuk lejohet ankesa.** Ndërsa lidhur me kushtet e pranueshmërisë së ankesës, Kolegji ju u referua nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrativ ku theksohet se: 1. *Ankesa është e pranueshme nëse i plotëson këto kushte: 1.1. nuk është përjashtuar shprehimisht nga ligji; 1.2. ankuesi ka legjitimitet në përputhje me nenin 124 të këtij Ligji; 1.3. ajo është parashtruar brenda afatit të parashikuar nga neni 127 i këtij ligji, dhe 1.4. çfarëdo kushte të tjera të parashikuara shprehimisht në ligj,* Andaj, meqenëse me nenin 225 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nuk lejohet e drejta e ankesës kundër vendimit për transferim të përkohshëm, rrjedhë së është e papranueshme ankesa A.nr.207/2022 e datës 04.03.2022, e parashtruar nga

Siç u tha me sipër, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nenparagrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrativ, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A. Nr. 207/2022

Ilire Mehmeti Shaqiri

Proçesmbajtëse



Ardita Haxhnikaj-Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Avokatit
- Zëvendësusit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës
- Udhëheqësit të Personelit në Shërbimin korrektues të Kosovës
- Arkivit të KPMSHCK-së,

